

MAJLINDA BUSHAJ

**PRANIA E GJUHËTARËVE ALBANOLOGË GJERMANË NË
OPUSIN E PROF. DR. DAVID LUKËS**

811.18:811.112.2

811.112.2:811.18

81(497)

Abstract: David Luka is one of the most important scholars in the field of Albanian language history. His name has entered in the historical linguistics, as a multidimensional linguist, one of the greatest of this century. He has worked in many fields, such as: historical grammar, etymology of Albanian language, lexicology, standard language, historical phonetics etc.

The work of German linguists, respectively Austrian, linguists is present in all the scientific work of David Luka. The Albanological studies of German albanologists continue to make up today the most important part of this science closely related to our ethno-genesis. German science has paid attention to the history of our language, the prehistoric and the historical period, the internal and the external history of Albanian and the written history of Albanian language within the framework of the Indo-European languages.

The study of Albanian language was carried out by a large number of personalities dealing with important issues such as the origin of Albanian, the historical composition of its lexicon, relations with other Indo-European languages and historical contacts with Balkan languages and other languages, source and the history of some elements of the grammatical structure and a range of other study topics as: *Gustav Mayer, Johann Georg von Hahn, Leiniz, Jokl* etc.

We inherit a very wealthy study fund from them, it was represented mainly by specialists in other language disciplines, who were partially or completely taken part in the study of Albanian language, customs and doctrines of Albanians. German albanologists helped to study lexicography, lexicology, etymology, phonetics, phonology, word formation, dialectology of Albanian language, and so on in a diachronic and synchronous plan.

Key words: Albanians, linguistic contribution, etymology, historical phonetics etc.

FILLIMET E SHKENCAVE ALBANOLOGJIKE

Fillimet e shkencave albanologjike mendohet se zënë fill me letrat që filozofi i madh gjerman Lajbnic i ka dërguar bibliotekarit mbretëror të Berlinit, të njohura në botën shkencore si *Letrat Shqiptare të Lajbnicit* (Albanerbriefe). Në letrën e datës 26 dhjetor 1709 ai merr në analizë disa fjalë të shqipes, duke dhënë mendim për prejardhjen e tyre (*hundë, krah, mish, burrë, grua, gaforre, çizme det, ka, /e/mirë*). Me Hanin mbyllet periudha parashkrimore e studimit të gjuhës shqipe.¹

Një punë sistematike dhe me parime e metoda shkencore të mirëfillta, nis me themelimin e gjuhësisë indoevropiane të krahasuar me veprën e F. Bobit. Në punimin “*Rreth shqipes në lidhjet e saj të prejardhjes*”, botuar më 1854, ai argumentoi jo vetëm se shqipja është një gjuhë indoevropiane, po edhe se ajo nuk ka ndonjë lidhje të veçantë me greqishten ose latinishten brenda familjes indoevropiane.

¹ Jup Kastrati, *Histori e albanologjisë*, Tiranë, 2000, f.16.

Sllavisti i njohur Franc Mikloshiç në tri vëllimet e veprës *Albanische Forschungen* (1870-1871) shqyrtoi elementet sllave e romane të shqipes. Më vonë ai studioi edhe huazimet turke. Punën e Mikloshiçit e saktësoi më tej H. Schuhard, veçanërisht përsa u përket ndikimeve latino-romane të shqipes.

Figura qendrore e studimit etimologjik të shqipes, në atë kohë e në vazhdim mbetet Gustav Majeri me *Fjalorin etimologjik* (1891) e me *Studimet shqiptare* I-VI (1883-1897), si dhe me studimet e mëvonshme. Me grumbullimin dhe trajtimin gati të të gjithë materialit gjuhësor që njihej deri në kohë të tij, me zbulimin dhe me zbatimin e disa ligjeve fonetike të shqipes së lashtë, me dallimin e elementit të trashëguar nga huazimi, Majeri e vështroi visarin leksikor të shqipes në tërësi në fondin indoevropian edhe në huazimet që ka marrë gjatë kohëve. Kështu fjalori i tij përbën edhe sot një nisje për çdo studim që ndërmerret në fushë të shqipes, sidomos në lëmin e etimologjisë e të leksikologjisë historike, e përjashta shqipes edhe në fushë të ballkanistikës.

Pas Majerit vija e zhvillimit të albanistikës është përcaktuar me emrat e Pedersenit dhe të Joklit. Holger Pedersen iu kushtua më shumë problemeve të gramatikës së shqipes dhe çështjeve që kanë lidhje me to, sesa atyre të etimologjisë së saj; po gjetja e disa rregullave fonetike të pavëna re sa duhet para tij dhe sqarimi i disa anëve të strukturës morfologjike të shqipes, sollën më vete mënjanimin e mjaft krahasimeve etimologjike të G. Majerit dhe njëkohësisht çelën rrugën për një vështrim më të drejtë të historisë së disa fjalëve të kësaj gjuhe. E shikuar në tërësinë e saj dhe në efektet që pati për drejtimin e mëtejme të albanistikës, rruga që çeli Pedersenit e që rrahu e zgjeroi Jokli pas tij me një punë shumëvjeçare, shënon një kthesë në këtë fushë gjurmimesh gjuhësore.¹

Gjuha shqipe nuk u shikua më si një gjuhë e përzier gjysmëromane. Asaj iu njohën tashmë, si në sistemin gramatikor si në visarin e fjalëve, shumë nga tiparet e veta të trashëguara, të pavëna re më parë.

Vepra e gjuhëtarëve albanologë gjermanë përkatësisht austriakë, folës gjermanë, që kanë shkruar gjermanisht është e pranishme në të gjithë veprën shkencore të prof. dr. David Lukës. Një vend të veçantë në opusin e tij kanë edhe studimet e tyre, që ndihmojnë në përcaktimin e shumë çështjeve të rëndësishme të historisë së gjuhës shqipe në fusha të ndryshme të saj.

Po paraqes disa nga autorët gjermanë që kanë peshë në veprën e Lukës.

Hahni (Johann Georg von Hahn) ka hyrë në historinë e kulturës shqiptare si një ndër albanologët më të shquar të shek. XIX. Personalitet i fuqishëm, diplomat, historian, gjuhëtar, etnograf, leksikograf, dijetar me erudicion të jashtëzakonshëm ai i ka sjellë dobi jo vetëm shkencës shqiptare, por drejtpërdrejt përpjekjeve të popullit tonë për të fituar lirinë e pavarësinë. Teza “pellazgjike” e prejardhjes së popullit shqiptar, e formuluar nga Hahni, u përdor me përfitim nga ideologët e Rilindjes për të rritur vetëdijen kombëtare dhe për të argumentuar tanimë edhe me fakte historike të drejtën e ligjshme për një shtet të pavarur, që të përfshinte të gjitha trojet e banuara nga shqiptarët.

Për herë të parë në historinë e antikitetit Hahni arriti të realizojë idenë se bota antike, krahas grekëve e romakëve, kishte pasur edhe një popull të tretë, sa të lashtë aq edhe të shquar, ilirët. Me një sërë argumentesh historike, mitologjike, etnografike, gjeografike e gjuhësore, ai përpigjet të provojë edhe përkatësinë etnike të njëjtë të maqedonasve të lashtë me ilirët dhe epirotët. Këtë treshe popujsh ai do ta emëronte si “bërthamën e fisit tireno-pellazgjik”. Kjo tezë do t’i shërbente rilindasve për të ngjallur vetëdijen dhe krenarinë e bashkëkohësve për popullin shqiptar si më të vjetrin në ballkan, duke e përdorur

¹ Shih: Petrit Kotri, *Vështrime rreth studimeve bashkëkohore për gjuhën shqipe në Austri dhe Gjermani*, Studime shqiptare V, Shkodër, 1996, f. 139-144. Një punim të plotë për studimet albanistike në hapësirën gjermanishtfolëse do ta ndeshim në artikullin e Izer Maksutit *Rreth studimeve albanistike në hapësirën gjermanishtfolëse-një vështrim i përgjithshëm*, Albanologjia, Vol.4, nr.7, Tetova, 2017, f.57-72.

këtë ide si mbështetje të fuqishme për bashkimin kombëtar të të gjithë trevave ku banonin shqiptarë. Idenë e autoktonisë së shqiptarëve në viset e tyre Hahni u mundua ta materializojë edhe me ndihmën e toponomastikës historike.

Ky që i pari që lidhi emrin e fisit ilir të Dalmatëve dhe të krahinës së Dalmacisë si edhe emrin e qytetit Delminium në Iliri. Emrin e Dardanëve e shpjegon me shqipen *Dardhë*. Mendimi që e lidh emrin e *Ulqinit* e lidh me fjalën shqipe *ulk*, *ulk* është dhënë për herë të parë nga Hahni¹. Në vazhden e kohëve, shumica e gjuhëtarëve, që erdhën pas tij, e pranuan këtë etimologji si të sigurt. Luka në një kumtesë, mbajtur në Ulqin në një simpozium shkencor titulluar “*Ulqini në rrjedhat e kohës*” shtron për emrin e Ulqinit një prejardhje të re². Përfundimet e tij i mbështet edhe në kërkimet e mëvonshme duke arritur në përfundimin se: “Emri Ulqin analizohet *Ul+k+in*, ku *Ul-* është refleksi i rrënjës indoevropiane **uel-*, me të cilën shpjegohet folja *ul,-k* është prapashtesa e vjetër e fosilizuar (refleksi shqiptar i formantit indoevropian-*ko*) dhe *-in/iun* përzierje e formantit vendës *-in*-me një latine-*inium*. Kuptimi bazë i fjalës mbetet “ultësirë, vend i ulët”, duke shprehur konfiguracionin e Ulqinit me rrethe, ku nga kodrat “zbritet” ëmbël në bregdet e në fushën e gjerë të Shtojit.³

Hahni që i pari që përqasi emrin *Vendum* të japodëve ilirë me emrin vend. Gjithashtu që po i pari që pati afruar emrin *Shkodër* me fjalën *kodër*. Hahni vuri re se prap.ilire *-ātes* (që formonte emra fisesh e popujsh i përgjigjet prap shqipe *-āt*, që formon emra fisesh e vllaznish si *Demi-Demāt* etj.

Që para një shekulli e gjysmë Hani vuri re se prapashtesa ilire *-ates*, që formonte emra fisesh e popujsh *Dalamtae, Labeate, Desidiate* i përgjigjet prapashtesën shqipe *-at*, që formon emra familjesh e vllaznish si: *Demi -Dema, Beqiri-Beqirat* etj. e emra vendesh të dala prej tyre si: *Dukat, Filat, Prognat* të përdorura më shumë në Jug, por jo të panjohura edhe në Veri.

Me këto shembuj Hahni çeli rrugën për të vërtetuar autoktoninë e shqiptarëve nëpërmjet toponomastikës historike, që është më konservative dhe ruan trajta më të vjetra se leksiku i gjuhës. Luka do ta rradhisë Hahnin me atë varg dijetarësh të shquar që hodhën themelet e një gjuhësie ilire të periodës paralinguistike. Me trashëgimin e tij shkencor, përfaqësuar tanimë me një numër veprash me vlerë, Hahni pasuroi kulturën shqiptare duke i sjellë kombëtare shqiptare që në kohën e tij shtrohej për zgjidhje.

V. Lajbnic, filozof gjerman me famë botërore, përveç kontributeve në fushën e filozofisë, matematikës, biologjisë, mekanikës etj. shfaqti interes edhe për gjuhësinë. Ai u interesua edhe për gjuhën shqipe, shtroi problemin e prejardhjes, të përkimeve, takimeve dhe marrëdhëniet e saj me gjuhët e tjera indoevropiane.

Për shumë studiues hipoteza e parë shkencore, rreth prejardhjes së gjuhës shqipe e të shqiptarëve vjen nga Lajbnici⁴-Gottfried Wilhelm von Leibniz (1646-1716) në një letërkëmbim nga Hanoveri me dijetarin francez ishte i pari që erdhi te teza ilire për shqipen dhe shqiptarët, duke konstatuar fafëfisninë me latinishten dhe keltishten. Në këto letra, në një periudhë mbi 20 vjet me radhë (qarkorja nga Vjena 1695, letra e parë 1709-e gjashtë drejtuar Vjenës 1714)debatohet për prejardhjen e gjuhës shqipe.⁵ Letrat e shqiptarëve janë botuar nga B. Demiraj.⁶ Këtu autori trajton edhe përqsasjet etimologjike në shkrimet e Lajbnicit me ato të shkrimeve kritike dhe bibliografike mbi të. B. Demiraj shkruan se “*Duke iu referuar përsëri shkrimeve të Lajbnicit, vështirë se mund të përcillet pa mëdyshje teza e tij mbi origjinën ilire të*

¹ J. G. von Hahn, *Albanesische Studien I*, Jena, 1954, f.238, 242.

² D. Luka, *Rreth prejardhjes së emrit Ulqin*, në vëll. “Ulqini në rrjedhat e kohës”, Ulqin 2000, f.185v.

³ D. Luka, *Studime gjuhësore*, VI, Shkodër, 2001, f. 60.

⁴ Dh. S. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Tiranë 1976, f.101 (nr.67-68, viti 1709). *Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane* (Përgatiti dhe përktheu nga origjinali Nelson R. Çabej), Tiranë, 1990, f.41-45.

⁵ I. Maksuti, *Rreth studimeve albanistike në hapësirën gjermanishtfolëse-një vështrim i përgjithshëm*, Albanologjia, Vol.4, nr.7, Tetova, 2017, f.58.

⁶ B. Demiraj, *Si ta lexojmë Lajbnicin*, SF, nr.1-2, 2001, f.163-175.

shqipes, të cilën ai e formulon në një rresht të vetëm, e që shpesh vetëm konstatohet si “intuitë e jashtëzakonshme” e Lajbnicit në historinë e albanologjisë dhe të ilirologjisë.”¹

Në studimin e Lukës “*Problemi i autoktonisë së shqiptarëve*”² gjejmë sqarime për analizën e materialit që do të merret në shqyrtim, si dhe leximin e saktë të letrave, më pas vjen interpretimi. Me *Letrat* shqiptare të Lajbnicit nis qoftë trajtimi i idesë së origjinës ilire të gjuhës shqipe, qoftë mendimi se shqiptarët janë autoktonë në viset ku banojnë që së lashti. “Lajbnici në analizën që u bën fjalëve të shqipes, nuk bën etimologji, ai vetëm krahason shtatë fjalë të shqipes (*hundë, krah, mish, burri, gaforreia, çisme, deet*) me fjalë të gjuhëve të tjera...Së paku koncepti i sotëm për etimologjinë nuk na lejon ta përdorim këtë term për analizën e fjalëve në *Letrat* e Lajbnicit, sepse aty kemi vetëm *histori* fjalësh a *krahasime* fjalësh.”³ Për Lukën Lajbnici “*mund të quhet vetëm pararendës i gjuhësisë krahasimtare, që do të lindte përafërsisht një shekull e gjysmë më vonë.*”⁴

Gustav Majer është vlerësuar nga dija e sotme gjuhësore si figurë madhore e albanologjisë,⁵ albanologu më i shquar i kohës së tij dhe njëri nga më të mëdhenjtë e të gjitha kohërave, që me dorë të sigurtë vuri gurë themeli në gjuhësinë shqiptare.⁶ Ai është i pari gjuhëtar indoevropianist, që studimeve të shqipes u kushtoi pjesën më të madhe të jetës dhe meqenëse studimet e kësaj natyre në kohën kur jetoi dhe punoi ishin ende në fillimet e tyre, atij i takon merita të ketë dhënë fjalën e parë e me kompetencë shkencore për shumë nga problemet kyçe të historisë së gjuhës shqipe.⁷ Vetë puna që, megjithëse ka kaluar shumë kohë, vepra albanologjike e Majerit mbetet ende në themelet e gjuhësisë historike shqiptare, tregon vlerën e veprës së tij.

Vepra më e rëndësishme e tij mbetet fjalori etimologjik i gjuhës shqipe. Vlora e këtij fjalori shumëfishohet po të mbajmë parasysh se shqipja në atë kohë që ndaluar të shkruhej në Shqipëri. Fjalori i Majerit analizon 5140 fjalë bazë të shqipes. Sipas autorit të mësipërm 1420 romane, 540 sllave, 1180 turke, 840 nga greqishtja e re dhe vetëm për 400 fjalë ai mundi të provojë se janë të burimit vendas, të trashëguara nga lashtësia indoevropiane, 730 fjalë nuk i zbërtheu dot dhe ia la studiuesve të mëvonshëm. Në gjendjen e sotme ky përpjestim ka ndryshuar ndjeshëm në të mirë të elementit vendas. Nga 730 fjalët e pazbërthyera prej Majerit tani është provuar se shumica i përkasin burimit shqiptar të trashëguar. Edhe shumë fjalë që Majeri i kishte nga latinishtja i janë kthyer shqipes.

Luka ka bërë përpjekje për t’i kthyer shqipes shumë fjalë të para si huazime nga Majeri duke ja kthyer shqipes si: fjalën *tarkaçe*-ja “trastë prej lëkure, jo shumë e madhe, që e mbajnë zakonishtë barinjët për të vënë bukën” Majeri e lë pa shpjegim, për Lukën *tarkall* e *tarkaç* ndeshen në krahinën e Mirditës me kuptimin “*calik që përdorej për të mbajtur raki, rrëshiq për raki*”. (Luka SGJ I:55).

Fjalën *i amëshuar* Majeri e shpjegon nga italishtja *immense*(Majer EW 10)Luka e sjell si kompozitë, e formuar si neologjizëm nga autorët e vjetër, ku pjesa e parë *amë* ka kuptimin “burim” a “zanafillë”ndërsa e dyta është pjesorja *shuem* “shuar” (Luka SGJ I:94).

Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe përbën bazën për të vendosur me dorë të sigurtë vendin që zë shqipja në familjen e gjuhëve indoevropiane në njërin anë, por edhe për të përcaktuar etnogjenezën si edhe për të

¹ B. Demiraj, *Si ta lexojmë Lajbnicin*, SF, nr.1-2, 2001, f.164.

² D. Luka, *Problemi i autoktonisë së shqiptarëve (Çështje parimesh dhe metode)*, në Studime rreth historisë së gjuhës shqipe, Tiranë, 2010, f.86.

³ D. Luka, *Problemi i autoktonisë së shqiptarëve (Çështje parimesh dhe metode)*, në Studime rreth historisë së gjuhës shqipe, Tiranë, 2010, f.91.

⁴ Po ai, po aty, f.91.

⁵ A. Omari, *G. Majer-figurë e madhe e etimologjisë*, në rev. Gjuha jonë, Tiranë, nr.3, 1990, 92-97.

⁶ K. Topalli, *Kontributi i Gustav Majerit për fonetikën historike të gjuhës shqipe në optikën e studimeve bashkëkohore*, SF, nr.1-4, 1996, f. 45.

⁷ Po aty, f.45.

provuar autoktoninë e popullit shqiptar. Në fjalorin etimologjik të Lukës, vepra e Majerit është një mbështetje. Po japim disa shembuj:

Shpjegimi që **shqip** mund të lidhet apo afrohet me latinishten *excipio* “kupto, dëgjo”, të cilën Majeri e jep në formën e parë *shqiponj* “ai që kupton”¹ për Lukën mbështetet me një arsytim logjik.² Ai pranon se folja *shqiponj* është thjesht një huazim nga latinishja në përdorim të përditshëm të asaj kohe, dhe se ndajfolja *shqip* duhet të jetë formim regresiv i përditshëm të saj. Për Lukën fillimisht duhet të kemi pasur në shqipe një folje *shqiponj*, por të ndërtuar sipas modelit të latinishtes, sepse foljet me *-o/jl*, janë formime brenda shqipes.

Fjala **nuse** gjen mbështetje, nga Majeri i cili në fillim gjen një fjalë vendi të shqipes, po më pas ndërroi mendim duke e quajtur fjalë të fondit autokton. Te gurra indoevropiane niset edhe Kretçmeri.

Për fjalën **ah-u**, Luka miraton shpjegimin në fjalorin e Majerit i cili e bie këtë fjalë si formim onomatopeik. (Luka SGJ I:91).

Fjala **lëngatë** për të cilën mendohej se lidhej me **legat**. Do të mjaftonte vetëm konsultimi me fjalorin e G. Majerit ku shkruhej mes të tjerash: *Ingāt* f. “sëmundje” shkodr.

Fjala **lugat** nuk ka shpjegim në fjalorin e Majerit, por shënon shprehje të mbledhura nga vende të ndryshme si *lugvat* “fantazmë shtëpie” në Berat etj.

Për **vjell** “nxjerr jashtë ushqimin që më përzien” Luka mbështetet te G. Majeri (EW 475), që e lidh me fjalën e shqipes me lat. *volvo* “rrotulloj, kthej”, gjerm. *e lartë e vjetër*. Për Lukën kjo etimologji qëndron si nga ana fonetike, ashtu edhe nga ana kuptimore.

Për etimologjinë e **shtërpinj** Luka sjell së pari mendimin e Majerit që kjo fjalë afrohet etimologjikisht me *gjarpër* në njërën anë, por edhe me *shterp* “krimbi që zë djathi” në anën tjetër.³

Për fjalën shqipe **gjerb**, G. Majeri (EW:139), pasi bën krahasimet me sllav. e vjetër dhe lat. rindërton për shqipen *serbō*: *gjerbō*. Duke u mbështetur në evolimet e fonetikës historike Luka arrin në përfundimin se: *gjerb* e shqipes, pra mund të gjykohet si fjalë vendëse e fondit autokton, nga një bazë **sōrb-*, që së pari **serb*, e në vazhdim *gjerb*.⁴

Vlera dhe rëndësia e këtij fjalori shtohet po të mbahet parasysh se shqipja në atë kohë qe ndaluar të shkruhej në Shqipëri, e cila rëndonte nën sundimin turk. Interesi i një personaliteti shkencor evropian të asaj kohe për gjuhën shqipe merrte së pari karakter politik, duke ndihmuar lëvizjen kombëtare për liri e pavarësi kombëtare. Çdo vepër shkencore mban vulën e kohës kur është shkruar, duke u kushtëzuar edhe nga materiali që ka autori në përdorim. Në kohën e Majerit shqipja nuk kishte as alfabet të njësuar, nuk njiheshin as meshari i Buzukut, as dy veprat e Budit. Autori nuk pati në dorë ndonjë fjalor të plotë të gjuhës shqipe (Kristoforidhit, Bashkimit) u botuan më vonë. Majeri punoi mbi një material të mangët duke njohur më shumë diasporën shqiptare se atdheun mëmë. “Fjalori i tij etimologjik ishte deri vonë i vetmi i këtij lloji dhe, ndonëse në disa drejtime i tejkaluar, mbetet mbetet një mjet konsultimi i domosdoshëm për të gjithë studiuesit e historisë së gjuhës shqipe. Edhe në ditët tona pothuajse nuk ka studim në fushën e historisë së gjuhës shqipe që të mos marrë parasysh punimet e Gustav Majerit.”⁵

Në artikullin “*Gustav Majeri më i madhi albanolog i kohës së vet*” Luka sjell një fakt të ri të pavënë re më pare nga studiuesit: “*Majeri nuk u interesua vetëm për gjuhën shqipe, por edhe për vetë Shqipërinë, që në*

¹ G. Meyer, *Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f.480.

² D. Luka, *Alban, Arbën/r/, Arbën/r/i dhe shqip, shqiptar, Shqipëri*, “Studime gjuhësore” XV (Vëzhgime, kërkime dhe studime në lëmin e gjuhës shqipe), Shkodër, 2013, f.243.

³ D. Luka, *Rreth tri problemeve për historinë e theksit në gjuhën shqipe*, në Studime rreth historisë së gjuhës shqipe, Tiranë, 2010, f.122.

⁴ D. Luka, *Studime gjuhësore II*, Shkodër, 2002, f.155 v.

⁵ A. Omari, *G. Majer-figurë e madhe e etimologjisë*, në rev. Gjuha jonë, Tiranë, nr.3, 1990, f. 97.

kohën e tij bënte përpjekje për të dalë nga sundimi turk. Ai botoi në shtypin e kohës një numër artikujsh për ngjarjet që lidheshin me Shqipërinë. Kulmi i protestave të tij qe letra që i drejtoi Ministrisë së Jashtme të Turqisë me kërkesën që të hiqte dorë nga ndalimi i gjuhës shqipe. Me këtë akt ai e radhiti veten ndër miqtë e dashamirët e vendit tonë, duke fituar të drejtën e ligjshme që të kujtohet me nderim të veçantë nga brezat që erdhën pas tij.”¹

Shumica e dijetarëve që janë marrë me autoktoninë e shqiptarëve e me çështjet e tjera që lidhen me të (si përkatësia ilire e shqipes) janë nisur nga konsiderata subjektive të paracaktuara. Nga një ide fikse niset edhe Shtadmyler i cili në fillim të viteve 60-të, pati një interes dhe klimë të favorshme edhe për studimet shqiptare.

Në veprën e tij ai përpiket të vërtetojë se djepi i shqiptarëve (në kohën e antikitetit të hershëm) duhet të ketë qenë zona malore e Matit.² Ky autor ndërmjet të tjerash pohon se vetëm në dy krahina nuk ka gjurmë romanizimi tek emrat e vendeve, në zonën e alpeve të Veriut dhe në zonën e Matit. Ky është mendim subjektiv, sepse duhej mbështetur në analizën e makro e mikrotoponimisë së këtyre zonave, e cila mungonte krejtësisht në atë kohë. Ky mendim kundërshtohet me fakte shkencore nga Luka. Ai vetë duke analizuar elementet e huaja në defterin e kadastrës osmane të vitit 1467, ka rreshtuar edhe elementet latine të mikrotoponimeve të zonës së Prellit dhe Rranxës në krahinën e Matit duke shpjeguar se “*Këto elemente latine, që në përpjestim me numrin e toponimeve latine të krejt vendit nuk janë të papërfillshme, na kujtojnë pyetjen e bërë nga E. Çabej nëse kemi të bëjmë me elemente latine të leksikut të shqipes*”, apo me “mbeturina gjuhësore të fundit të një elementi roman të dikurshëm të vendit”.³ Mikrotoponime të tilla dalin: *Valca* “pyll” në Melth; *Val* “lagje” në Dukagjin; *Valxhi* “lagje në Macakull”; *Valca* “pyll” në Macakull; *Vali* “përrua” në Laç-Bruç; *Shutrrreja* “gurrë e madhe” në Laç-Bruç. Dalin edhe emra të formuar me prap. –*et* e –*el* që mbahen me gurrë latine: *Kashnjeti i Patushit* “pyll me gështenja” në Prell; *Funanjeli* “tokë” në Gjoçaj; *Shkozet* “shpat me shkozë” në Lami i Madh etj.

Qenia e këtyre toponimeve me burim nga latinishtja, flet për vjetërsinë e tyre dhe të banorëve që i kanë ruajtur gojë më gojë brez pas brezi deri më sot. Duke shtuar këtu edhe se “Vendbanimi i sotëm i shqiptarëve nuk është një trevë ekspansioni, por një trevë restriksioni, përfundim i një ngushtimi të paprerë gjatë historisë së shqiptarëve” Luka bashkohet me mendimin e E. Çabejt se ky problem te Shtadmyler “*është i parë tepër ngushtë*”⁴.

Studiuesi gjerman G. Shram me veprën e tij “*Origjina e krishterimit shqiptar*” 1994⁵ shkaktoi zemërim kur u botua, sepse kundërshtonte teorinë mbizotëruese të origjinës ilire të popullit shqiptar. Shrami në veprën⁶ e tij flet për prejardhjen e shqiptarëve nga një fis malësor trakas i quajtur bes, i kthyer që herët në besimin kristian, banorët e të cilit rreth shek. IX, për shkak të përndjekjeve të bullgarëve paganë u vendosën prapa Durrësit, përafërsisht në krahinën e Arbënisë, mendim i cili është kundërshtuar edhe nga autorë të tjerë. Për Lukën Shrami është historian që operon me mjete gjuhësore, pa qenë i informuar sa duhet për fonologjinë historike të shqipes. Shrami punon mbi madhësi të panjohura (ose pak të njohura) dhe me këtë mënyrë argumentet gjuhësore që ai sjell, qoftë lidhjen e trakishtes me dakishten (përkat. Frigishten), qoftë dallimet që besishtja na paska me vetë trakishten, mbeten vetëm hamendje. Luka me krahasime gjuhësore të plota, hedh poshtë mendimet e Shramit për lidhje birërie mes dy gjuhëve,

¹ D. Luka, *Gustav Majeri-më i madhi albanolog i kohës së vet*, botuar në Studime shqiptare V, Shkodër, 1996, f.17.

² G. Stadtmüller, *Forschungen zur albanischen Frühgeschichte*, OTTO HARRASSOWITZ, WIESBADEN, 1996, f.76v.

³ D. Luka, *Regjistri turk i vitit 1467*, në “Studime gjuhësore” VI, Shkodër, 2001, f.142.

⁴ E. Çabej, *Studime gjuhësore*, IV, Prishtinë, 1975, f.147.

⁵ G. Schramm, *Anfänge des albanisches Christentums-Die frühe Bekehrung der Bessen und ihre langen Folgen*, Freiburg, 1994.

⁶ G. Schramm, *Anfänge des albanisches Christentums-Die frühe Bekehrung der Bessen und ihre langen Folgen*, Freiburg, 1994.

veçanërisht kur njëra prej tyre (shqipja) është e dokumentuar vonë, ndërsa tjera (besishtja) pothuaj nuk njihet fare në sistemin e saj strukturor, aq sa për t'u bërë objekt krahasimi.

Për Lukën nuk mund të jetë argument për të vërtetuar apo jo filiacionin ndërmjet dy gjuhëve si: ndërkallja e një /t/ ndërmjet /s/ e /r/ te rrënja indoevropiane *sreu “rrjedh”, e cila gjen pasqyrim ose jo te këto dy gjuhë. Ai sjell si shembull etimologjinë e fjalës *gjarpër* në bashkëlidhje me *shtërpinj*.¹

Hans Krahe. Gjuhëtar gjerman, indoevropianist. U mor me zbërthimin e venetishtes e të ilirishtes e në mënyrë të veçantë me problemin e gjuhës në kohën parahistorike, kryesisht në bazë të emrave të lashtë të ujërave (hidronomisë).

Ai u mor për shumë dekada me studimin e gjuhës ilire. Ka lënë një numër të madh veprash në gjuhën gjermane si për: emrat e vjetër gjeografikë ballkano-ilirë, fjalorin e emrave vetjakë të ilirëve, gjuhët indo-gjermane etj.²

Në veprat e Lukës ky autor shërben në sqarimin e shumë çështjeve, por në disa raste ka edhe diskutime duke mbështetur me fakte shkencore në fushën e onomastikës.

Në studimin “*Rreth prejardhjes së emrave Epidamnos-Dyrrhachion*” Luka sjell emrin e një personi **Damen** për të cilën H. Krahe e përfshin në emrat e burimit ilir. (Die alt.23). Ky mendim është mbështetur edhe nga A. Majer (Die Sprach.46), të cilën Luka e shikon me rezervë për emër ilir. Për Lukën kjo fjalë është emërtim grek, kompozitë e përbërë, që shpreh konfiguracionin e vendit që emërton.³

Veprat e A. Krahes⁴ edhe pse në mjaft raste ka mospërputhje të shpjegimeve të dhëna, sepse punohet me madhësi të panjohura ose pak të njohura, veçanërisht në strukturën gjuhësore, ato shërbejnë si bazë niseje në fushën e onomastikës, sepse paraqesin një përmbledhjeje të mirë me emra njerëzish e vendesh, nuk mund të mos merren në konsideratë për çdo studiues që studion onomastikën ilire.

Në studimin “*Vëzhgime mbi toponomastikën ilire*” për klasifikimin e toponimeve me prap. –at Luka mbështetet në veprën e Krahes (Die Spach.) sipas të cilit këto emra mund të paraqesin elemente të përbashkëta indoevropiane dhe të jenë mjaft të lashta. H. Krahe si përfundim i kërkimeve në fushën e emrave më të vjetër të rrjedhave të ujit, e quajtur prej tij “*Hidronomi e hershme evropiane*”. Ai në kundërshtim me mendimet e veta të mëparshme, arriti në përfundimin se egziston një hidronomi e lashtë e Evropës e njëjtë me prejardhje indoevropiane.⁵ Për Lukën qënia e prap.-at si element i përbashkët i shtresës indoevropiane, nuk e kundërshton trashëgimin e –at të shqipes nga ilirishtja.

Vepra e Antun Majerit dha një kontribut të rëndësishëm në onomastikën historike. Mjaft nga shembujt e Majerit shërbejnë si mbështetje shkencore në veprën e Lukës, por ka edhe raste diskutimesh. A. Majeri mendon se: “në truallin e sotëm shqiptar pothuaj se kurrkund nuk egzistojnë emra tipikë që të jenë ruajtur në gojë të shqiptarëve që nga koha e lashtë..”(Die sprach. I, 14). Ky mendim trajtohet nga Luka, i cili merr në shqyrtim emrat e lumenjve, maleve me rëndësi, e pastaj mbeturinat e emrave të fiseve. Luka sjell si shembuj emra ilirë që dalin në të njëjtën trajtë në krahina të ndryshme. Përkime toponimesh të sotme me toponime ilire, që mund të jenë lidhje filiacioni qoftë për shkak të përputhjes së zhvillimit të tyre me

¹ D. Luka, *Studime për historinë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2010, f. 100.

² H. Krahe, *Die alten balkanillyrischen geographischen Namen* (Heidelberg 1925); *Lexikon altillyrischen Personennamen* (1929); H. Krahe *Indogermanische Sprachwissenschaft* (Berlin 1948); H. Krahe, *Ortsnamen als Geschichtsquelle* (Heidelberg 1949); *Die Sprache der Illyrier I. Die Quellen* (1955). "Languages of the Illyrians I: Sources", a summary of his previous work. Volume II. *Die messapischen Inschriften und ihre Chronologie* ("Messapian inscriptions and their chronology") is by Carlo de Simone and Volume III. *Die messapischen Personennamen* ("Messapian personal names") by Jürgen Untermann. (Wiesbaden 1964). *Die Struktur der alteuropäischen Hydronymie* (Wiesbaden 1963). *Unsere ältesten Flussnamen* (1964). *Germanische Sprachwissenschaft. Wortbildungslehre*. (Berlin 1969).

³ D. Luka, *Rreth prejardhjes së emrave Epidamnos-Dyrrhachion*, SGJ, VI, Shkodër, 2001, f.55.

⁴H. Krahe, *Die alten balkanillyrischen geographischen Namen* (Heidelberg 1925); *Lexikon altillyrischen Personennamen* (1929).

⁵ D. Luka, *Vëzhgime mbi toponomastikën ilire*, Studime gjuhësore, VI, Shkodër, 2001, f.9.

rregullat e fonetikës historike të shqipes, qoftë për identifikim, qoftë për punë të afri së gjeografike. Emra të tillë dalin në veprën e Lukës: *Zara* (qytet në Dalmaci), *Shikaj* (fshat në rreth të Kukësit), *Dushmani* (fis e fshat në Dukagjin), *Manjeni* (fusha e përroni në Pukë), *Vjosa* (Lumi), *Devolli* (lumi e krahina), *Shurdhaku* (toponim në lindje të Shkodrës), *Shoshi* (krahinë në Shqipëri të Veriut) etj.

Jokli. Gjuhëtar austriak, indoevropianist, albanolog. Ai i kushtoi tërë jetën e tij studimit të gjuhës shqipe nga shumë aspekte.¹ Punoi sidomos në fushën e etimologjisë e të fjalëformimit historik, të marrëdhënieve të shqipes me gjuhët e tjera, për fonetikën e morfologjinë historike të saj. Si studime më vete botoi: *Studime për etimologjinë*² dhe *fjalëformimin dhe Gjurmime gjuhësore e historike*³. Hartoi studime të shumta që u botuan në përmbledhje e organe shkencore të ndryshme, disa edhe pas vdekjes. Në punimet e tij ai trajtoi çështje të rëndësishme të historisë së jashtme e të brendshme të gjuhës shqipe, në veçanti burimin e gjuhës shqipe. Mbrojti autoktoninë e shqiptarëve, por duke e vendosur djepin e tyre të parë në *Dardaninë* e lashtë. Ai i kushtoi vëmendje të madhe elementit vendës, në radhë të parë elementit trashëgimor indoevropian. Ai i çoi mjaft përpara gjurmimet etimologjike shqiptare. Rishikoi mjaft etimologji dhe dhe hodhi dritë mbi prejardhjen e shumë fjalëve të shqipes, duke provuar burimin vendës të mjaft elementeve të mbajtura si huazime.⁴ Jokli dha një ndihmesë të çmuar edhe për fonetikën historike të shqipes. Luka i ka kushtuar një kumesë me titull “*Ndihmesa Joklit për fonetikën historike të shqipes*”⁵ Këtu po vë në dukje disa nga mendimet e autorit.

Për periudhën parahistorike ai hapi shtigje të reja në trajtimin e apofonisë dhe për refleksat e likuidave silabike. Në konsonantizëm ai qe i pari që përcaktoi refleksin *sk*-indoevropiane në *ç*- në fjalët si *çel* etj. si dhe tjetrin *ad/h/ dh/th/*. Nga periudha historike e gjuhës ai ndoqi fazat e ndryshme të diftongimit të zanores *o* në *ua ue* (*krua, duar*) gjithnjë në bashkëlidhje me dëshmitë e dialekteve e të dokumenteve të tjera shkrimore, por edhe të marrëdhënieve të shqipes me gjuhët e tjera të Ballkanit. Jokli dha një ndihmesë të mirfilltë edhe për çështje të tjera si për studimin e theksimit, duke përcaktuar rregullimin mekanik të theksit në pajtim me parimin e theksimit të rrokjes parafundore.

Refleksat e guturaleve indoevropiane në gjuhën shqipe përbëjnë një nga çështjet më të vështira të fonetikës historike. Shaban Demiraj ka vënë në dukje se edhe për vetë fonetikën e krahasuar indoevropiane, kjo çështje mbetet ndër më të diskutueshmet.⁶

Me përfundimin tjetër se: “...në refleksat e guturaleve indoevropiane ne e shohim shqipen në vijën kufitare midis grupit lindor e perendimor”, Jokli hapi shtigje të reja për rrafshimin e mendimit të prerë, që pati egzistuar në kohë të tij seriozisht vërtetimin shkencor të tezës së origjinës ilire të gjuhës shqipe e të popullit shqiptar, sa kohë që ilirishtja karakterizohej si gjuhë *kentum*, ndërsa shqipja *satem*.⁷

Kush ka pasur mundësi të studiojë tërësisht veprën e Joklit, do të ketë vënë re se pothuaj embrionet e çështjeve që do të bëhen objekt studimesh të veçanta në veprat e gjuhëtarëve të mëvonshëm e sidomos në veprën e David Lukës janë dhënë me qartësi e saktësi të habitshme.

Mendimet e Majerit dhe të Joklit shërbejnë si mbështetje shkencore në mjaft çështje të trajtuara si: evolucioni (zhvillimi) historik i një -ó-je të theksuar në rrokje të mbyllur, pasuar nga një -n fundore, për

¹ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor enciklopedik shqiptar*, (vëll. II), Tiranë, 2008, f. 1068-1069.

²N. Jokl, *Studien zur albanesischen Etymologie und Wortbildung*, Vjenë, 1911.

³N. Jokl, *Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen*, Berlin –Leipzig, 1923.

⁴ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor enciklopedik shqiptar*, (vëll. II), Tiranë, 2008, f. 1069.

⁵ D. Luka, *Ndihmesa Joklit për fonetikën historike të shqipes*, kumesë e mbajtur në Konferencën Shkencore Albanologjike *Albanologu i shquar austriak Nobert Jokli* (1877-1942), botuar në Studime shqiptare 12, Shkodër, 2003. (Materiale të Konferencës Shkencore Albanologjike në nderim të albanologut të shquar austriak, Nobert Joklit), organizuar nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore të USH “Luigi Gurakuqi”, më 28-29 qershor 2002).

⁶ Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f. 37v.

⁷ D. Luka, *Studime gjuhësore* VII, Shkodër, 2002, f. 170.

fonetikën historike të shqipes paraqitet si problem i vështirë dhe ende i pa zgjidhur bindshëm. Kushtet për diftongimin e kësaj zanoreje të thjeshtë në vendosjen e sipërthënë i përcaktoi së pari G. Majeri¹. Më pas N. Jokli kalimin nga *-on* në *-ua/ue* e shpjegoi në gjashtë faza. Pothuajse të gjitha studimet e kryera për zhvillimin *ó/n/ > -ua/-ue* nisin nga parashtimi i N. Joklit.²

Në fushën e etimologjisë mendimet e studiuesve gjermanë janë një ndihmesë e madhe në shpjegimin e shumë fjalëve. Për prejardhjen e fjalës *qen*, Majeri e shpjegon nga një *cenis* të metafonizuar. Luka mbështet mendimin e Joklit i cili miratohet edhe nga Çabej që për fjalë të kësaj natyre (krs. qelq, shelg etj.) procesi ka ndodhur përbrenda shqipes, në mënyrë që kjo *e* është e shumësit të singularizuar. Në këtë situatë një *kan-*, mund të zhvillohej më tej në **ken-* vetëm nëpërmjet trajtës *kan-i* përkatësisht një shumësi të singularizuar. Nga zberthimi i *e-së* në *ie* ngjan të **ken- *kjen > qen-*.

Luka duke renditur toponimet që shpjegohen me anë të shqipes Luka përmend *Lopsica*, qytet në Liburni, *Lopsi*, emri etnik, *Lopsët*, fis ilir. Duke u nisur nga thënia e Hesiodit këto toponime ai i krahason me fjalën shqipe *lopë*. Për këtë gjen mbështetje te Jokli “shq. *Lopë*, let. *luops* “gjë e gjallë”. Luka mbështet mendimin e Joklit se këtu kemi të bëjmë ndoshta me një element të kulturës paraindoevropiane.³

Në punimin *Për kohën e formimit të gjuhës shqipe* Luka sjell shembullin se “në mbishkrimet e gjetura në Scarnantia të Panonisë, te *Tergitio* N. Jokli gjen përgjegjësen ilire të lat. *negotiator* “tregtar, duke e barazuar me fjalën ilire *tergitio* me shqipen “tregës”.⁴

Jokli pa e njohur trajtën e përdorur te Buzuku, vuri re lidhjen ndërmjet tyre, duke e shpjeguar këtë *vjedmis* si *mjedvis* “mes-vend”, një formim analog me latinishten *medius locus*. (Luka, *Studime për historinë*, f.119).

Gustav Vajgand. Gjuhëtar gjerman, studiues i njohur në fushën e ballkanologjisë.⁵ Përmendet si studiues i rumanishtes, por u mor edhe me studimin e gjuhëve të tjera të Evropës Juglindore, veçanërisht me shqipen dhe bullgarishten. Dukuritë e përbashkëta të shqipes, të rumanishtes dhe të bullgarishtes i shpjegoi me një nënshtresë të përbashkët trake. Qe mbrojtësi kryesor i tezës se shqipja buron nga trakishtja, të cilën ai e shtjellon në artikullin “*A janë shqiptarët pasardhës të ilirëve apo të trakëve?* (Ballkan Arkiv, III, 1927). Kjo tezë u hodh poshtë nga gjuhëtarët shqiptarë dhe të huaj. Në vitin 1913 botoi në Laipzig veprën “*Gramatikë e dialektit të gegërishtes jugore*”, ndërsa një vit më vonë botoi “*Fjalorin gjermanisht-shqip dhe shqip-gjermanisht me 3000 fjalë*”.⁶

Luka në punimin “*Rreth problemit të kohës së formimit të gjuhës shqipe*” citon mendimin e Gustav Vajgandit i cili vë në dukje në veprën e tij *egzistencën e një shtrese të moçme të huazimeve latine të shqipes*,⁷ mendim i cili i shërben si mbështetje në përcaktimin e saktë të kohës së formimit të gjuhës shqipe.

Në qoftëse përfundimet që arriti Vajgandi për prejardhjen dhe vendbanimin e hershëm të shqiptarëve, ishin të gabuara, të dhënat e mbledhura nga ky njohës i mirë i gjuhëve ballkanike dhe hulumtues i zellshëm i toponimisë mbeten një trashëgimi shkencore me vlerë. Ato u dhanë nxitje kërkimeve shkencore të mëvonshme, të cilat çuan në krijimin e një disipline të re gjuhësore, të gjuhësisë ballkanike.⁸ Këta janë disa nga albanologët më kryesorë të cituar nga Luka, në veprën e tij ndeshin një numër të madh studiuesish albanologë gjermanë dhe austriakë, por ky artikull nuk na lejon shtrirje më të gjerë.

¹ G. Meyer, *Kurzgefasste albanische Grammatik*, Leipzig, 1888. *Albanesische Studien* III, Wien, 1892.

² D. Luka, *Studime për historinë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2010, f.161.

³ N. Jokl, *Marrëdhëniet e afri së shqipes me gjuhët e tjera indoevropiane*, SF 3, 1967, f.131.

⁴ D. Luka, *Studime për historinë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2010, f.79.

⁵ B. Demiraj, *Gustav Vajgandi-Albanolog i shquar*, Gjuha jonë, Tiranë, 1/1990, f.90-96.

⁶ *Gjuha jonë*, 1/90, Tiranë, f.98.

⁷ G. Weigand *Balkan-Archiv* III 178, shën.1.

⁸ B. Demiraj, *Gustav Vajgandi-Albanolog i shquar*, Gjuha jonë, Tiranë, 1/1990, f.95.

Përmendim këtu: F. Mikloshiq, K. Jiriçek, M. Lambertz, Karl Patç, K. Treimer, Ksilander, M. Lubke, A. Thumb, V. Breu etj.

PËRFUNDIME

Gjuha shqipe dhe populli shqiptar kanë tërhequr prej kohësh vëmendjen e botës shkencore evropiane e sidomos të asaj gjermane. Me njohjen dhe studimin e gjuhës shqipe, të historisë së popullit shqiptar u morën disa figura të shquara të botës shkencore evropiane, filozofë, historianë dhe gjuhëtarë.

David Luka është një nga studiuesit më të rëndësishëm në fushën e historisë së gjuhës shqipe. Emri i tij ka hyrë në gjuhësinë historike, si një gjuhëtar shumëdimensional, një nga më të mëdhenjtë e këtij shekulli. Ai ka punuar në shumë fusha, si: gramatikë historike, etimologji e gjuhës shqipe, leksikologji, gjuhë standarde, fonetikë historike etj.

Vepra e gjuhëtarëve albanologë gjermanë dhe austriakë, përkatësisht folës gjermanë, që kanë shkruar gjermanisht është e pranishme në të gjithë veprën shkencore të prof. dr. David Lukës. Studimet e albanologëve gjermanë vazhdojnë të përbëjnë edhe sot pjesën më të rëndësishme të kësaj shkence të lidhur ngushtësisht me etnogjenezën tonë. Një vend të veçantë në opusin e tij kanë edhe studimet e tyre, që ndihmojnë në përcaktimin e shumë çështjeve të rëndësishme të historisë së gjuhës shqipe në fusha të ndryshme të saj.

Shkenca gjermane i ka kushtuar rëndësi historisë së gjuhës sonë, periudhës parahistorike dhe asaj historike, historisë së brendshme dhe të jashtme të shqipes dhe historisë së shkruar të gjuhës shqipe brenda kuadrit të gjuhëve indevropiane. Me studimin e gjuhës shqipe u morën një numër i madh personalitetesh që trajtuan çështje të rëndësishme, si prejardhja e shqipes, përbërja historike e leksikut të saj, raportet me gjuhët e tjera indoevropiane dhe kontaktet historike me gjuhët ballkanike dhe me gjuhët e tjera, burimi dhe historia e disa elementeve të strukturës gramatikore dhe një sërë temash të tjera studimore.

Albanologët gjermanë ndihmuan për studimin e leksikologjisë, etimologjisë, fonetikës, fonologjisë, fjalëformimit, dialektologjisë së gjuhës shqipe etj. në plan diakronik dhe sinkronik. Në veprat e Lukës veprat e këtyre autorëve shërbejnë si mbështetje për ta çuar më përpara shkencën gjuhësore historike shqiptare e në të njëjtën kohë edhe për trajtimin e çështjeve të diskutueshme të cilat kërkojnë zgjidhje siç është p.sh. prejardhja e gjuhës shqipe, vendi i saj në bashkësinë gjuhësore indoevropiane, vendi dhe koha e formimit, autoktonia, periodizimi etj.

Studiuesit albanologë gjermanë na kanë lënë një fond shumë të pasur studimor, i cili përfaqësohet kryesisht nga specialistë të disiplinave të tjera gjuhësore, që u morën pjesërisht ose tërësisht me studimin e gjuhës shqipe, zakoneve dhe dokeve të shqiptarëve.

BIBLIOGRAFI E SHFRYTËZUAR¹

Albanologu i shquar austriak Nobert Jokli (1877-1942), Studime shqiptare 12, Shkodër, 2003. (Materiale të Konferencës Shkencore Albanologjike në nderim të albanologut të shquar austriak, Nobert Joklit), organizuar nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore të USH “Luigj Gurakuqi”, më 28-29 qershor 2002).

Anila Omari, *G. Majer-figurë e madhe e etimologjisë*, në rev. Gjuha jonë, Tiranë, nr.3, 1990, 92-97.

Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane (Përgatiti dhe përktheu nga origjinali Nelson R. Çabej), Tiranë, 1990, f.41-45.

Bardhyl Demiraj, *Gustav Vajgandi-Albanolog i shquar*, Gjuha jonë, Tiranë, 1/1990, f.90-96.

Bardhyl Demiraj, *Si ta lexojmë Lajbncin*, SF, nr.1-2, 2001, f.163-175.

¹ Këto janë disa nga punimet kryesore, të tjerat janë cituar gjatë artikullit.

David Luka, *Studime gjuhësore*, I 1999, II 2002, III 2003, IV 2003, V 1999, VI 2001, VII 2002, VIII 2003, IX 2006, X 2007, XI 2008, XII 2010, XIII 2011, XIV 2012, XIV 2013, XVI 2014, XVII 2015, XVIII 2016, XIX 2017 Shkodër.

David Luka, *Gustav Majeri-më i madhi albanolog i kohës së vet*, botuar në Studime shqiptare 5, Shkodër 1996, f.13-18.

David Luka, *Histori e gjuhës shqipe* (Albanologji), Përmbledhje leksionesh e studimesh), Shkodër, 2005.

David Luka, *Studime për historinë e gjuhës shqipe*, (Vepër e zgjedhur), botim i QSA, Tiranë, 2010.

Dh. S. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Tiranë 1976, f.101 (nr.67-68, viti 1709).

Eqrem Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes III*, Tiranë, 1987.

Georg Stadtmüller, *Forschungen zur albanischen Frühgeschichte*, OTTO HARRASSOWITZ, WIESBADEN, 1996.

Gottfried Schramm, *Anfänge des albanisches Christentums-Die frühe Bekehrung der Bessen und ihre langen Folgen*, Freiburg, 1994.

Gustav Meyer, *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*. Strassburg. 1891.

Gustav Meyer, *Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007.

Izer Maksuti, *Rreth studimeve albanistike në hapësirën gjermanishtfolëse-një vështrim i përgjithshëm*, Albanologjia, Vol.4, nr.7, Tetova, 2017, f.57-72.

Jup Kastrati, *Historia e Albanologjisë*, Tiranë, 2000.

Kolec Topalli, *Kontributi i Gustav Majerit për fonetikën historike të gjuhës shqipe në optikën e studimeve bashkëkohore*, SF, nr.1-4, 1996, f. 45-48.

Mina Gero, *Maksimilian Lamerci për gjuhën shqipe*, botuar në Studime shqiptare 5, Shkodër 1996, f.123-128.

Petrit Kotri, *Nobert Jokli dhe vepra e tij albanologjike*, botuar në Studime shqiptare 12, Shkodër 2003, f.12-24.

Petrit Kotri, *Studime bashkëkohore për gjuhën shqipe në Austri e Gjermani*, botuar në Studime shqiptare 5, Shkodër 1996, f.139-144.

Shaban Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988.